



**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN

PROJEKTI PËR PJESËMARRJE QYTETARE

# LISTË FAKTESH / 2017

**f** CEP MACEDONIA

## KOMPONENTI DY:

### FORCIMI I ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE

PROJEKTI I USAID-IT PËR PJESËMARRJE QYTETARE (PPQ), QË FILLOI ME AKTIVITET NË GUSHT TË VITIT 2016, E FORCON PJESËMARRJEN KONSTRUKTIVE TË ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE (OSHC-VE) NË POLITIKAT DHE ÇËSHTJET ME INTERES PUBLIK, E RRIT DHE E MBËSHTET PËRFSHIRJEN E TË RINJVE NË JETËN PUBLIKE NË MAQEDONI.

QËLLIMI I PËRGJITHSHËM I PPQ-SË ËSHTË RITJA E KAPACITETIT TË OSHC-VE DHE GRUPEVE TË TË RINJVE PËR TË: AVANCUAR POLITIKAT PUBLIKE, PËRMIRËSUAR SHËRBIMET PUBLIKE, PROMOVUAR QEVERISJEN E MIRË DHE PËR TË KONTRIBUAR NË PËRMIRËSIMIN E STANDARDIT JETËSOR NË MAQEDONI.

#### PPQ-JA I MBËSHTET OSHC QË FOKUSOHEN NË KËTO FUSHA KRYESORE:

- Sundimi i Ligjit
- Anti-korrupsioni
- të Drejtat e njeriut
- Rritja ekonomike
- Mjedis i volitshëm për zhvillim të biznesit
- Monitorim dhe mbikëqyrje e institucioneve

## Aktivitetet dhe Rezultatet e Komponentit Dy

Në kuadër të Komponentit Dy, PPQ-ja siguron grante dhe asistencë për zhvillim të kapaciteteve të OSHC-ve për:

- **Zgjerim dhe forcim të anëtarëve të tyre dhe pjesëmarrjen e këtyre anëtarëve në aktivitete të cilat trajtojnë problemet primare të qytetarëve;**
- **Forcim të praktikave të tyre menaxhuese për t'u bërë OSHC të qëndrueshme;**
- **Bashkëpunim me mediat, sektorin privat, shoqërinë akademike dhe institucionet publike për çështje me interes të përbashkët; dhe**
- **Nxitje të rritjes së diturive dhe kapaciteteve si dhe mbështetje të zmadhuar për iniciativat e OSHC-ve nëpërmjet krijimit të rrjeteve rajonale, Evropiane dhe Ndërkombëtare.**

PPQ-ja është projekt pesë-vjeçar që financohet nga misioni i Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar në Maqedoni (USAID). PPQ-ja implementohet nga East West Management Institute në partneritet me Fondacioni për Internet dhe Shoqëri "Metamorfozis", Asociacioni për Iniciativa Demokratike (AID), Fondacioni për Shoqëri të Hapur në Maqedoni (FSHHM) dhe Këshilli Rinor Nacional i Maqedonisë (KRNМ).

#### AKTIVITETET KRYESORE TË KOMPONENTIT DY:

- Ndarje e granteve për mbështetje strategjike;
- Ndarje e granteve për Reagim të shpejtë;
- Sigurim i asistencës për zhvillim të kapaciteteve për të gjithë përfituesit e granteve nga PPQ-ja, duke përfshirë edhe menaxhimin e anëtarësisë dhe ndihmën e brendshme;
- Sigurim i mjeteve, për përfituesit e granteve nga PPQ-ja, për pjesëmarrje qytetare;
- Mbështetje të iniciativave për të përmirësuar imazhin publik të OSHC-ve.

#### REZULTATET KRYESORE QË PRITEN:

- Mbështetje nga PPQ për rreth 21 OSHC që udhëheqin iniciativa të suksesshme për pjesëmarrje qytetare në fushat e tyre prioritare;
- Adresim i së paku 10 zhvillimeve të paparashikuara politike nga OSHC-të që mbështeten nga PPQ-ja;
- Përmirësim i kapaciteteve organizative dhe për avokati të grantistëve të PPQ-se dhe rritje të aftësive të tyre për të thithur fonde prej më tepër burimeve;
- Grantistët e PPQ-së të zhvillojnë bashkëpunim të gjerë dhe kuptimplotë me OSHC tjera, mediat, sektorin privat, shoqërinë akademike dhe institucionet publike për të përmirësuar mirëqenien e publikut

Kjo listë faktesh është përgatitur nga Projekti i USAID-it për Pjesëmarrje Qytetare me mbështetje të Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar. Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim nuk i reflektojnë domosdo pikëpamjet e USAID-it dhe Qeverisë së SHBA-ve.